

Përshëndetje!

Të dashur vëllezër dhe motra na lejoni që tju përshendesim në rradhë të parë dhe urojmë që të jeni mire të gjithë. Ne duam t'ju raportojmë për aktivitetin që kemi bërë në dt 21 maj 2011 me rastin e ditës së Jetimëve. Përsëri ky aktivitet u bë në bashkëpunim me FPU, W-CARP dhe Shoqatës "Jetimët në Fokus" këtu në Korçë.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte dhënia e disa ushqimeve dhe më tepër se kaq të mund të krijojmë një atmosferë familjare për të cilën ata kanë shumë nevojë.



Aktiviteti u bë i mundur falë punës së ApP që bashkëpunuan me këtë shoqatë dhe studentëve të W-CARP të cilët për 3 ditë kanë bërë mbledhje fondesh për të siguruar ushqimet e nevojshme për 30 jetimët e kësaj shoqate. Në mbledhjen se fondeve kanë marrë pjesë edhe të rinj që sapo jane njohur me lëvizjen të cilët kishin një dëshirë dhe frymëzim të madh për të bashkëpunuar dhe për të ndihmuar edhe ata jetimët .

Aktiviteti filloi me fjalën përshëndetëse të Ermir Hoxhes liderit të qëndrës së Korçës ,ku ne prani të mediave uroi të gjithë jetimët për ditën e tyre dhe kërkoi që të festonim te gjithë së bashku në këtë ditë. Pas fjalës përshëndetëse kryetari i shoqates së jetimëve Z. Mirash Zefi na falenderoi për ndihmën që i dhamë. Ajo cfarë vumë re ishte që shumë prej jetimëve aty kishin një dëshirë të madhe për të ndarë me ne zemrën e tyre të vuajtur, të mospasjes së një familje dhe falë besimit të tyre në Zot kanë arritur të përballojnë vështirësitë e jetës.



Me pas aktiviteti ka vazhduar me një party dhe koktelj të vogël duke ju dhënë mundësinë atyre që të gëzojnë në këtë ditë. Të gjithë edhe pse me problem donin të harronin gjithcka thjesht të gëzonin më njëri tjetrin dhe shpesh herë na falenderonin që ne ishim bashkë me ta atë ditë.

Në fund u bë ndarja e uhqimeve për të gjithë.

Gjithashtu edhe Z. Berti Kotmilo kryetari i FPU në Korçë u shpreh shumë i kënaqur nga aktiviteti që u zhvillua dhe për këtë falenderoi të gjithë të rinjtë e W-CARP për investimin e tyre.

Raportoi Anila Haziraj